



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

**Këshilli
Konsultativ**



Procesverbali i Mbledhjes

Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 24 qershor 2026

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e Mbledhjes.....

1. Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të komisionit këshillimor për titujt e nderit”2
2. Projektvendimi “Për landfillet e mbetjeve”.....3
3. Projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”4
4. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në menca dhe konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” i ndryshuar.....6
5. Projektvendimi “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore”8
6. Projektvendimi “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”11
7. Projektvendimi “Për organizimin, funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe procedura e shqyrtimit të ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje”.12
8. Projektvendimi “Për rregullat dhe procedurat e monitorimit të situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe organizimin dhe zbatimin e monitorimit dhe inspektimit të shërbimit”13
9. Projektvendimi “Për kriteret dhe procedurat e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje”14
10. Projektvendimi ”Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje dhe kriteret, procedurat dhe instrumentet për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje”15
11. Projektvendimi “Për rregullat dhe procedurat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ në familje, ofrimin dhe përfundimin e shërbimit, funksionimin e komisionit shumë disiplinor dhe për vlerësimin e pro edurës dhe vendimmarrjen për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje”16
12. Prezantim “Udhërrëfyes mbi planin vjetor të aktiviteteve të komisionit të këshillimit ad hoc” “Mekanizëm për verifikimin e përfshirjes së rekomandimeve të këshillit konsultativ” “Guide praktike mbi metodologjinë e hartimit të rekomandimeve/ propozimeve për iniciativa ligjore”16
13. Shtojcë: Të pranishëm19

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 17.4.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 24 qershor 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ.

Mbledhja plenare u zhvillua në orën 12:30, në Pallatin e Kongreseve, në Sallën e “Albanologjisë”.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe përfaqësues të organizatave dhe donatorëve ndërkombëtarë.

Mbledhja u kryesua nga z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillit të Qarkut Tiranë, njëkohësisht bashkëkryetar i Këshillit Konsultativ, i cili, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi shoqatat dhe përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në punimet e Këshillit.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA:

1. Projektvendimi “Për përcaktimin e kritereve, procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të Komisionit Këshillimor për Titujt e Nderit”

Z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Bashkëkryetar i Këshillit Konsultativ, hapi mbledhjen duke përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe duke i falënderuar për pjesëmarrjen në këtë takim.

Në vijim, ai i dha fjalën z. Dekavelli, Drejtor, Ministria e Punëve të Brendshme i cili prezantoi projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve, procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të Komisionit Këshillimor për Titujt e Nderit”.

Z. Dekavelli sqaroi se projektvendimi është hartuar në zbatim të ligjit nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht nenit 14, pika 4. Ai theksoi se objektivi kryesor i projektvendimit është plotësimi i vakumit procedural përmes krijimit të një kuadri të qartë administrativ, i cili eliminon paqartësitë dhe mungesën e standardeve që kanë karakterizuar procesin deri më tani.

Më tej, ai paraqiti në mënyrë të përmbledhur elementet kryesore të projektvendimit, të cilat përshijnë:

- Përcaktimin e rregullave të detajuara për ngritjen, organizimin, përbërjen dhe ushtrimin e përgjegjësive të Komisionit Këshillimor;

- Përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit dhe shqyrtimin objektiv e profesional të kandidaturave;
- Garantimin e transparencës, paanshmërisë, shmangies së konfliktit të interesit dhe verifikimit të plotë të informacionit për çdo kandidat;
- Rregullimin e procedurave administrative që lidhen me dokumentimin, marrjen e informacionit shtesë dhe administrimin e dosjeve pranë institucionit përgjegjës.

Në përfundim të prezantimit, z. *Dekavelli* theksoi se efekti kryesor që synohet të arrihet nëpërmjet këtij projektvendimi është rritja e transparencës, përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë publike ndaj procesit të dhënies së titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë.

Komente nuk ka.

Z. Dalipi ja kaloi fjalën *znj. Elvana Ramaj, Drejtoreshë në Ministrinë e Mjedisit*, për prezantimin e projektvendimit si më poshtë.

2. Projektvendimi “Për landfillet e mbetjeve”

Znj. Elvana Ramaj, Drejtor në Ministrinë e Mjedisit, prezantoi projektvendimin “Për landfillet e mbetjeve”, të hartuar në zbatim të Ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 37/2026. *Znj. Ramaj* sqaroi se projektvendimi është hartuar në përputhje me Direktivën 1999/31 të Bashkimit Evropian “Për landfillet e mbetjeve”, të ndryshuar në vitin 2024, dhe përbëhet nga 9 krerë, 23 nene dhe 9 shtojca teknike, duke rregulluar të gjithë ciklin e jetës së landfilleve. Gjithashtu, *znj. Ramaj* theksoi se projektvendimi synon të mbështesë tranzicionin gradual drejt ekonomisë qarkulluese, nëpërmjet zbatimit të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, ndarjes së tyre në burim, grumbullimit të diferencuar, riciklimit, kompostimit dhe rikuperimit, me synim reduktimin progresiv të depozitimit në landfille. Ajo bëri të ditur se objektivi për vitin 2035, në përputhje me periudhën tranzitore të kërkuar nga Shqipëria, është që vetëm 10% e mbetjeve bashkiake të depozitohen në landfille.

Më tej, *znj. Ramaj* sqaroi se projektvendimi vendos standarde të unifikuara teknike dhe mjedisore për funksionimin e landfilleve, sipas tre kategorive të mbetjeve: të rrezikshme, të parrezikshme dhe inerte. Ajo informoi se landfillet rajonale në dhjetë zonat e menaxhimit të mbetjeve do të administrohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). Lejet mjedisore do të përfshijnë, krahas detyrimeve të përgjithshme, edhe kërkesa specifike për monitorimin e ujërave dhe gazeve, programet e mbylljes dhe rehabilitimit, si dhe raportimin periodik dhe raportimin në rast incidentesh. Sipas saj, AKM do të monitorojë cilësinë dhe saktësinë e të dhënave nëpërmjet sistemit të integruar mjedisor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në vijim, *znj. Ramaj* evidentoi dy elemente novatore të projektvendimit. Së pari, vendosjen e mekanizmave të garancisë financiare, duke parashikuar dy kategori garancish: gjatë fazës së operimit dhe gjatë periudhës pas mbylljes së landfillit, në zbatim të parimit “ndotësi paguan”. Së dyti, detyrimin për kujdes pasues, sipas të cilit operatori mbetet përgjegjës për monitorimin dhe mirëmbajtjen e landfillit për një periudhë jo më pak se 30 vjet pas përfundimit të operimit, deri në rehabilitimin e plotë të tij. Gjithashtu, *znj. Ramaj* sqaroi gjithashtu se projektvendimi nuk parashikon mbylljen automatike të venddepozitimeve ekzistuese që nuk përmbushin standardet e Bashkimit Evropian, por një proces

gradual përmirësimi dhe përshtatjeje. Financimi për mbylljen dhe rehabilitimin e tyre do të sigurohet nëpërmjet projekteve të financuara nga donatorët ndërkombëtarë, përfshirë KfW, e cila mbështet pesë zona të menaxhimit të mbetjeve, si dhe Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD), në bashkëpunim me projektin e Bashkimit Evropian për ekonominë qarkulluese.

Në përfundim të prezantimit, *znj.Ramaj* theksoi se projektvendimi pritet të kontribojë në rritjen e mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit publik, minimizimin e ndotjes, rritjen e normave të riciklimit, si dhe në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të integruar të menaxhimit të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë.

Komente;

Z. Fran Brahimi, Drejtor në Ministrinë e Financave, vlerësoi rëndësinë e nismës, por shprehu rezerva në lidhje me mungesën e qartësisë mbi implikimet financiare dhe funksionale të zbatimit të saj, në veçanti, për kostot që mund të lindin nga mbyllja e venddepozitimeve ekzistuese, transporti i mbetjeve drejt landfilleve alternative, si dhe ndarja e përgjegjësisë financiare ndërmjet institucioneve përgjegjëse. *Z.Brahimi* theksoi se njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë ende qartësi mbi mënyrën e përballimit të tarifave të reja operative, si dhe kërkoi që pesë çështje specifike të trajtohen dhe të reflektohen në projektvendim përpara vijimit të procedurave të miratimit. Në përgjigje të komenteve, *znj.Ramaj* sqaroi se vërejtjet e Ministrisë së Financave janë administruar nëpërmjet sistemit elektronik të akteve dhe po reflektohen në relacionin shoqëruar të projektvendimit, si dhe theksoi se Shqipëria ka kërkuar një periudhë tranzitore 15-vjeçare për zbatimin e Direktivës dhe se vlerësimi i kostove sipas kategorive është përfshirë në Planin Specifik të Implementimit (DSIP) dhe në Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) të projektligjit. Sipas saj, këto elemente do të pasqyrohen më qartë në relacion, me qëllim sqarimin e plotë të implikimeve financiare. Gjithashtu, *znj.Ramaj* informoi se projektvendimi i rishikuar do t'u ridërgohet ministrive të linjës për bashkërendim institucional.

Z.Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq, argumentoi mbi tarifën e landfilleve rajonale, konkretisht ato të landfillit të Korçës, nëse do të jenë të unifikuara për të gjitha landfillët apo do të përcaktohen veçmas për secilin prej tyre. *Znj.Ramaj* sqaroi se tarifën nuk janë objekt i këtij projektvendimi dhe se ato nuk do të jenë uniforme, por do të përcaktohen në varësi të kostove të administrimit dhe operimit të secilit landfill. *Znj.Vasilika Vjero, Zëvendëskryetare*, bashkia Tiranë shtoi se tarifën do të përcaktohen nga operatorët që administrojnë landfillët dhe jo nga bashkitë, duke sjellë si shembull rastin e Bashkisë Tiranë, ku landfilli nuk administrohet nga vetë bashkia.

Në vijim, *znj.Ramaj* konfirmoi se, me kalimin e administrimit të landfilleve rajonale tek AKEM Sh.a, ky subjekt, në bashkëpunim me bashkitë përkatëse, do të kryejë vlerësimin e kostove sipas metodologjisë përkatëse dhe do të përcaktojë tarifën e pranimit të mbetjeve në secilin landfill.

Në përfundim të diskutimeve, *z. Dalipi* kaloi në shqyrtimin e pikës së radhës të rendit të ditës si vijon.

3. Projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”

Z. Dalipi i dha fjalën *znj. Klodjana Marikaj*, Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Ministria e Mjedisit, për prezantimin e projektvendimit “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”.

Znj. Marikaj sqaroi se projektvendimi është hartuar në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 89/2025 “Për gjuetinë” i cili synon standardizimin e procedurave dhe dokumentacionit për dhënien me qira, nëpërmjet konkurrimit publik, të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe sqaroi se sipërfaqja e zonave të gjuetisë përcaktohet deri në 500 hektarë për zonat fushore dhe deri në 1000 hektarë për zonat malore, të cilat shoqërohen detyrimisht me zona mbarështimi, me qëllim garantimin e ruajtjes dhe ripërtëritjes së stokut të faunës së egër. Më tej, *znj. Marikaj* sqaroi se gjuetia lejohet vetëm në zonat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, bazuar në inventarizimin e faunës së kryer nga bashkitë dhe në rast se nuk paraqiten propozime përkatëse, gjuetia në ato zona nuk lejohet. Ndërsa, lidhur me procedurën e konkurrimit, ajo shpjegoi se projektvendimi parashikon një procedurë të detajuar në 17 pika. Procesi fillon me ngritjen e komisionit të konkurrimit nga kryetari i bashkisë brenda 10 ditëve, vijon me shpalljen publike të procedurës për një periudhë jo më të shkurtër se 30 ditë dhe përfundon me zhvillimin e konkurrimit brenda 15 ditëve pune nga përfundimi i afatit të aplikimit.

Znj. Marikaj sqaroi se sistemi i vlerësimit të ofertave i jep përparësi ofertës teknike, e cila vlerësohet me deri në 75 pikë, ndërsa oferta financiare vlerësohet me deri në 25 pikë, me kusht që vlera e ofertuar e qirasë të mos jetë më e ulët se çmimi fillestar i përcaktuar, si dhe theksoi se zbatimi i projektvendimit nuk sjell kosto shtesë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, por krijon mundësi për gjenerimin e të ardhurave shtesë për bashkitë.

Komente:

Znj. Vjero, Zv/kryetare e bashkisë Tiranë propozoi që draftkontrata për dhënien me qira të miratohet nga Këshilli Bashkiak, duke iu referuar nenit 9 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, sipas të cilit kompetencat që lidhen me administrimin e pronës nuk mund të delegohen nga organi përfaqësues, si dhe argumentoi se ky parashikim është i nevojshëm për garantimin e një procesi të rregullt institucional dhe ushtrimin e kompetencave të Këshillit Bashkiak. Gjithashtu, *znj. Vjero* ngriti një çështje juridike lidhur me koherencën e procedurës, duke theksuar se, nëse propozimet për shpalljen e zonave të gjuetisë bëhen nga bashkia si institucion dhe jo nga Këshilli Bashkiak, atëherë edhe procedura për dhënien e tyre në përdorim duhet të ndjekë të njëjtën logjikë institucionale.

Në vijim të diskutimit, *znj. Marikaj* argumentoi rastet kur asetet janë pronë e bashkisë, nëse dhënia e tyre me qira ose në përdorim kërkon në çdo rast miratimin e Këshillit Bashkiak, pavarësisht zhvillimit të procedurës së konkurrimit.

Znj. Vjero sqaroi se kontratat me afat deri në një vit mund të nënshkruhen nga kryetari i bashkisë, ndërsa kontratat me afat mbi një vit kërkojnë miratimin paraprak të Këshillit Bashkiak. Një përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore sugjeroi, si zgjidhje kompromisi, që Këshilli Bashkiak të miratojë zonat e gjuetisë dhe njëkohësisht t'i japë mandat kryetarit të bashkisë për zhvillimin e procedurës së qiradhënies, ndërsa kontratat konkrete të vijojnë sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi, me qëllim shmangien e vonesave procedurale.

Në përfundim të diskutimeve, z. Dalipi mbylli diskutimin mbi këtë projektvendim dhe njoftoi kalimin në shqyrtimin e pikës së radhës të rendit të ditës, lidhur me projektvendimin e paraqitur nga Ministria e Arsimit si vijon;

4. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, 'Për kuotat financiare të ushqimit në menca dhe konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike', të ndryshuar”

Znj. Oriana Osmani, Zëvendësministër, Ministria e Arsimit, prezantoi projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, 'Për kuotat financiare të ushqimit në menca dhe konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike', të ndryshuar”

Znj. Osmani sqaroi se projektvendimi është hartuar mbi bazën e analizës së zbatimit disavjeçar të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666/2019, si dhe pas një procesi të gjerë konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sipas saj, qëllimi kryesor i ndryshimeve është adresimi i problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të aktit, si vonesat administrative, paqartësitë në ndarjen e kompetencave dhe mungesa e njëtrajtshmërisë në procedura, me synim krijimin e një sistemi më të drejtë, transparent dhe efikas për mbështetjen e nxënësve përmes bursave dhe shërbimeve sociale.

Znj. Osmani sqaroi se ndryshimet e propozuara mbështeten në katër shtylla kryesore;

- *Së pari*, parashikohet qartësimi i procedurave të aplikimit pranë institucioneve arsimore, përmes dokumentimit me procesverbale, duke garantuar gjurmueshmërinë e procesit dhe mbrojtjen e të drejtave të aplikantëve;
- *Së dyti*, zgjidhet paqartësia procedurale për rastet kur nxënësit banojnë në një bashki dhe ndjekin arsimin në një bashki tjetër, duke përcaktuar qartë institucionin përgjegjës për trajtimin e kërkesave;
- *Së treti*, vendoset muaji mars si afat përfundimtar për paraqitjen e kërkesave për fonde nga bashkitë, ndërsa vonesat pas këtij afati do të mbulohen nga buxhetet vendore, me qëllim forcimin e disiplinës financiare dhe administrative;
- *Së katërti*, projektvendimi rrit fleksibilitetin në administrimin e fondeve të kufizuara, duke u dhënë mundësi Këshillave Bashkiakë të zbatojnë kriterë prioritare dhe skemën e gjysmëbursës.

Projektvendimi garanton dhënien e jo më pak se 5000 bursave në vit për arsimin profesional dhe si një prioritet kombëtar krijon bazën ligjore që bashkitë, në përputhje me kapacitetet e tyre financiare, të ofrojnë shërbimin e ushqimit në shkolla, si dhe parashikon indeksimin e përvitshëm të vlerës së bursave sipas normës së inflacionit, duke filluar nga viti 2027.

Në përfundim të prezantimit, *znj. Osmani* theksoi se projektvendimi synon të realizojë tre objektiva kryesorë;

- rritjen e drejtësisë në shpërndarjen e mbështetjes financiare për nxënësit;
- forcimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor;
- zgjerimin e instrumenteve të mirëqenies në institucionet arsimore, duke kontribuar në barazinë e mundësive dhe zhvillimin afatgjatë të fëmijëve.

Komente:

Znj. Vjero ngriti një shqetësim lidhur me dispozitat që rregullojnë ofrimin e shërbimit të ushqimit në kuadër të programit të pasmësimit, si dhe theksoi se formulimi aktual krijon paqartësi lidhur me kategorinë e përfituesve, duke mos qenë e qartë nëse shërbimi do t'u ofrohet të gjithë nxënësve që përfitojnë sipas VKM-së apo vetëm nxënësve të klasave I-V që ndjekin programin e pasmësimit. Në këtë kuadër, ajo sugjeroi që dispozita përkatëse të riformulohet për të shmangur çdo paqartësi në zbatim, duke bërë me dije se komentet e detajuara do të përcillen edhe me shkrim.

Në përgjigje, *znj. Osmani* sqaroi se shërbimi i ushqimit është konceptuar kryesisht për nxënësit e klasave I-V që ndjekin programin e pasmësimit dhe se planifikimi i këtij shërbimi duhet të orientohet sipas kësaj kategorie, si dhe shprehu gatishmërinë e Ministrisë së Arsimit për të shqyrtuar të gjitha sugjerimet e paraqitura nga bashkitë.

Më pas, *z. Brahimi* vlerësoi projektvendimin si një hap pozitiv në drejtim të rritjes së mbështetjes sociale për nxënësit, si dhe theksoi se ofrimi i shërbimit të ushqimit nuk është një detyrim për të gjitha bashkitë, por një e drejtë që mund të ushtrohet në varësi të kapaciteteve financiare të secilës njësi të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, *z. Brahimi* shtroi pyetjen nëse parashikohet miratimi i një akti të posaçëm që do të rregullojë standardet dhe protokollat e ofrimit të këtij shërbimi, përfshirë dietat ushqimore, llojet e ushqimeve dhe mënyrën e organizimit të shërbimit.

Znj. Osmani theksoi se Ministria e Arsimit është duke bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për hartimin e një akti nënligjor që do të rregullojë këto aspekte teknike.

Më tej, *znj. Irena Toshkallari, Zv/kryetare e Bashkisë Vlorë*, argumentoi;

- *Së pari*, evidentoi problematikën që lidhet me afatin e muajit mars për paraqitjen e kërkesave për fonde, duke theksuar se fondi i kushtëzuar për bursat përfundon në muajin dhjetor dhe rihapet vetëm pas alokimit të fondeve në muajin mars, çka krijon një boshllëk financiar prej tre muajsh gjatë të cilit nxënësit e arsimit profesional mbeten pa mbështetje financiare ku sugjeroi rishikimin e kësaj dispozite.

- *Së dyti*, çështja e trajtimit të nxënësve të klasës së dhjetë që kanë përfunduar arsimin bazë në institucione private dhe regjistrohen në arsimin publik, si dhe anasjelltas. Duke iu referuar praktikës së Bashkisë Vlorë, e cila mbështet me bursa të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret, kërkoi që kjo situatë të sqarohet në mënyrë të shprehur në projektvendim.

Në përgjigje, *znj. Osmani* sqaroi se nxënësit që kanë përfunduar arsimin bazë në institucione private dhe regjistrohen në arsimin publik nuk përfitojnë bursë, ndërsa në rastet kur kalimi bëhet nga arsimi publik në atë privat, ruhet e drejta për përfitimin e bursës për periudhën e ndjekur në sistemin publik.

Në vijim, *Elson Reçi, Sekretar i Përgjithshëm i bashkisë Mat* ngriti një tjetër çështje lidhur me trajtimin e bursave për nxënësit e klasave XI dhe XII që ndjekin arsimin në një bashki tjetër nga ajo e vendbanimit. Ai theksoi se ndryshimet e mëparshme të VKM-së nr. 666 kanë sjellë praktika të ndryshme ndërmjet bashkive, duke krijuar paqartësi mbi institucionin përgjegjës për financimin e bursës. Ai kërkoi sqarim nëse projektvendimi i ri e adreson përfundimisht këtë problem dhe garanton vijimësinë automatike të bursës nga klasa X deri në klasën XII.

Znj. Osmani bëri të ditur se kjo çështje kërkon një verifikim të mëtejshëm teknik dhe se Ministria e Arsimit do të japë një përgjigje përfundimtare pas shqyrtimit të saj.

Në vijim, *Ervin Gjini, Përgjegjës Konviktesh në bashkinë Shkodër*, theksoi se bashkia i kishte paraqitur komentet e saj me shkrim dhe ngriti një shqetësim lidhur me kuotën financiare të ushqimit për shkollat speciale. Sipas tij, shtesa prej 140 lekësh e parashikuar në projektvendim është e pamjaftueshme për të përballuar kostot reale të ushqimit, ndaj kërkoi rishikimin e kësaj vlere.

Në përfundim të diskutimeve, *znj. Osmani* falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për komentet dhe rekomandimet e paraqitura, duke konfirmuar se ato do të shqyrtohen gjatë fazës përfundimtare të hartimit të projektvendimit, si dhe ritheksoi se ndryshimet e propozuara pritet të mbështesin zhvillimin e modelit të shkollës me kohë të zgjatur, të përmirësojnë rezultatet në të nxënë, të promovojnë barazinë dhe përfshirjen sociale, të rrisin pjesëmarrjen në programet e pasmësimit, të forcojnë edukimin ushqimor të nxënësve dhe të harmonizojnë kuadrin kombëtar me praktikën dhe rekomandimet ndërkombëtare.

5. Projektvendimi “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore”

Z. Alqi Kushi, Drejtor i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit prezantoi projektvendimin. “*Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore*”. Në kuadër të kësaj pike, *z. Kushi* theksoi se akti është hartuar me asistencën teknike të ekspertëve të SIGMA-s dhe në përputhje me parimet e OECD për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve shtetërore. Projektvendimi funksionon si instrument i drejtpërdrejtë zbatimi i masës 1.1.3 të Growth Plan për Ballkanin Perëndimor, e cila synon përmirësimin e qeverisjes së ndërmarrjeve shtetërore nëpërmjet forcimit të kuadrit ligjor, rritjes së profesionalizmit të bordeve dhe vendosjes së proceseve të rekrutimit të hapura e meritokratike. Akti zbatohet për të gjitha shoqëritë aksionare me kapital shtetëror në pronësi të institucioneve qendrore dhe vendore, në masën që nuk bien ndesh

me akte të posaçme ligjore. Në thelb të tij, dokumenti synon të kalojë nga një kuadër i fragmentuar në një model të konsoliduar qeverisjeje korporative, duke përcaktuar rregulla të qarta për përbërjen, përzgjedhjen, emërimin, funksionimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen e këshillave mbikëqyrës. Projektvendimi parashikon që numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të përcaktohet në statut, dhe se shumica e anëtarëve të emëruar duhet të jenë të pavarur, duke respektuar njëkohësisht barazinë gjinore në përbërje.

Z. *Kushi* theksoi procedurën e re të emërimit, e cila ndërton një filtër profesional ndërmjet pronarit dhe Asamblesë së Përgjithshme. Procesi nis me hartimin e kërkesës për vakancat dhe pritshmërisë nga pronari, dokument që përcakton objektivat dhe pritshmëritë e performancës, dhe vazhdon me shpallje publike të vendeve vakante, paraqitje të aplikimeve, vlerësim nga Komisioni i Përhershëm i Emërimit, propozim me justifikim të listës finale dhe emërim nga Asambleja. Në rast mospranimi të kandidatëve, kërkohet fillimi i një procesi të ri përzgjedhës, sidhe specifikoi kriteret minimale që duhet të plotësojnë kandidatët: a) përvojë në drejtim dhe menaxhim ekzekutiv, b) njohuri në financë, c) qeverisje korporative, ç) risk dhe pajtueshmëri, d) kompetencë teknike sektoriale sipas fushës së veprimtarisë së shoqërisë, dh) integritet, e) etikë profesionale dhe aftësi vendimmarrëse në interesin e shoqërisë.

Ndër garantët e procesit u përmendën:

- Vlerësimi i dokumentuar dhe propozimi i arsyetuar;
- Trajtimi i barabartë i kandidatëve dhe respektimi i barazisë gjinore;
- Mbajtja e regjistrimit të kandidatëve të kualifikuar; si dhe monitorimi i portofolit dhe i performancës së anëtarëve.

Projektvendimi parashikon që shumica e anëtarëve të emëruar të jenë të pavarur dhe që kryetari i këshillit mbikëqyrës të zgjidhet nga radhët e anëtarëve të pavarur, qasje kjo që përputhet me parimin OECD për borde profesionale me gjykim të pavarur.

Z. *Kushi* shpjegoi se pavarësia e anëtarit vlerësohet sipas katër kriterëve kumulative:

- Mungesës së çdo marrëdhënieje pune ose kontraktuale me shoqërinë në tre vitet e fundit;
- Mungesës së lidhjeve me aksionarët apo administratorët;
- Mosushtrimin të funksioneve politike në tre vitet e fundit dhe mosqenies funksionar politik aktiv;
- Mosqenies nëpunës i administratës publike.

Gjithashtu, z. *Kushi* sqaroi se nuk parashikohet përjashtim automatik, por çdo rast vlerësohet individualisht sipas kompetencës, pavarësisë dhe konfliktit konkret të interesit. Mekanizmat mbrojtës përfshijnë: a) deklarinin e konfliktit të interesit para dhe gjatë mandatit, b) verifikimin periodik, c) përjashtimin nga vendimmarrja dhe shkarkimin në rast shkeljesh të rënda. Çdo komision përbëhet nga katër anëtarë të pavarur ekspertë me mandat tre-vjeçar, një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga institucioni/ sektori përgjegjës ose bashkia përkatëse, si dhe një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë. Kryetari zgjidhet nga radhët e anëtarëve të pavarur. Detyrat kryesore të komisioneve janë: përcaktimi i kriterëve për pozicionet vakante; organizimi i thirrjeve të hapura, shqyrtimi, vlerësimi dhe intervistimi i kandidatëve; propozimi i kandidatëve për emërim

dhe mbajtja e regjistrit të kandidatëve të kualifikuar; si dhe monitorimi i përbërjes së këshillave në nivel portofoli. Komisioni analizon sipas kriterëve aplikimet dhe i paraqet Asamblesë listën e aplikimeve me argumentimet përkatëse. Asambleja emëron kandidaturën e ardhur nga komisioni i emërimeve, por ka edhe të drejtën për refuzimin e arsyetuar të kandidaturës dhe në këtë rast komisioni do të sjellë një kandidaturë tjetër të shoqëruar me argumentat justifikues.

Projektvendimi parashikon cikle të rregullta raportimi dhe llogaridhënieje: a) katër mbledhje dhe katër raportime minimale në vit, b) vetëvlerësim vjetor i këshillit, c) vlerësim i jashtëm çdo tre vjet për shoqëritë strategjike, d) publikim i raportit vjetor, vendeve vakante dhe Letrës së Pritshmërisë.

Z. *Kushi* theksoi se VKM nr. 570/2018 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të projektvendimit të ri, si dhe se brenda gjashtë muajve komisionet e reja duhet të vlerësojnë anëtarët ekzistues të këshillave mbikëqyrës.

Komente;

Z. *Ervis Moçka, Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë*, vlerësoi synimet që kërkon të përmbushë ky projektakt lidhur me rritjen e profesionalizimit dhe depolitizimin e këshillave, si dhe parashitroi dy komente në lidhje me projektaktin:

- *Së pari*, argumentoi lidhur me cënimin e autonomisë vendore, duke sqaruar se në ligjin 139/2015, neni 54 parashikon se këshillat vendorë kanë tagër të përcaktojnë vetë statutin dhe aktin e themelimit të shoqërive tregtare dhe janë pronarë në 100% të tyre, si aksionar i vetëm. Në këtë rast duket sikur i zhvesh ose e kufizon nga autonomia për të përzgjedhur vetë. Këshilli ka përgjegjësi të plota financiare dhe ligjore, por në fund projektakti duket sikur e detyron këshillin vendor që të pranojë një kandidaturë nga një komision i jashtëm, i cili shton hallka dhe afate kohore, ndoshta të panevojshme. Sipas tij, është shumë e rëndësishme që të shihet me kujdes përputhshmëria ligjore me ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe ligjet e tjera për shoqëritë tregtare dhe QKR.
- *Së dyti*, z. *Moçka* shtroi se projektakti nuk parashikon zgjidhje në rastin e një bllokimi institucional të mundshëm kur komisioni i emërimeve i propozon për emërim këshillit një kandidaturë, të cilën këshilli në mënyrë të argumentuar e refuzon dhe kjo ndodh edhe me propozimin e dytë, të tretë e kështu me radhë, pra, nëse do ketë mekanizma të parashikuar për të zhbllokuar këtë proces dhe për të siguruar dakordësi.

Z. *Kushi* sqaroi se detyrimi për propozimin e një anëtari të këshillit mbikëqyrës ekziston edhe tani, pra në pyetjen nëse ky propozim do të vijë nga një anëtar i këshillit apo nga komisioni, për këshillin nuk përbën ndryshim. Synimi është që të kemi një komision profesional dhe të depolitizuar.

Znj. *Vjero*, argumentoi lidhur me komisionin e emërimeve dhe përbërjen e tij.

Z. *Kushi* sqaroi edhe një herë përbërjen e tre komisioneve, procesin e shpalljes dhe rekrutimit të anëtarëve, hartimin e rregulloreve të funksionimit të tyre, hyrjen në fuqi dhe parashikimin e procedurave të vlerësimit të anëtarëve aktualë të këshillave mbikëqyrës sipas afatit përkatës. Ai theksoi se dokumenti është hartuar pas disa fazave diskutimesh dhe duke pasur parasysh rekomandimet e ekspertëve të SIGMA-s dhe parimet e OECD-së, si dhe sqaroi se janë marrë informacione

nga të gjitha institucionet qendrore dhe nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për të gjitha shoqëritë e ngritura pranë NJVV-ve. Gjithashtu, sqaroi se në një periudhë tre-vjeçare është parashikuar një raport mbi bazën e të cilit do të mund të vlerësohet edhe ecuria e zbatimit të këtij mekanizmi të ri, edhe me ndihmën e SIGMA-s dhe OECD-së.

Znj.Vjero kërkoi gjithashtu rishikimin e shpërblimeve monetare të këtyre komisioneve, duke sqaruar se shpesh krijohen struktura të mirëpaguara dhe që nuk janë efektive, sepse strukturat që kanë vërtet vendimmarrjen janë të nënpaguara.

Z. Dalipi kërkoi që të merren parasysh të gjitha rekomandimet në mënyrë që të zbatohet qëllimi që ka Këshilli Konsultativ.

6. Projektvendimi “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

Znj. Etleva Sheshi, Drejtor për Barazinë Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prezantoi projektaktin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

Znj.Sheshi sqaroi se qëllimi kryesor i projektvendimit është përcaktimi i rolit, përbërjes, mënyrës së funksionimit dhe përgjegjësi të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) pranë çdo bashkie, me synim parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në nivel vendor, si dhe shpjegoi se MKR-ja përbën strukturën kryesore operacionale në nivel vendor dhe organizohet mbi tre komponentë kryesorë institucionalë:

- Komitetin Drejtues;
- Ekipin Teknik Ndërdisciplinar (ENT);
- Koordinatorin Vendor.

Lidhur me Komitetin Drejtues, *znj. Sheshi* sqaroi se ai është organi përgjegjës për bashkërendimin strategjik të veprimtarisë ndërinstitucionale në nivel vendor. Përbërja e tij është e përhershme dhe përfshin përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të drejtësisë, Policisë së Shtetit, shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore, si dhe organizatave të shoqërisë civile. Komiteti Drejtues ka përgjegjësi për drejtimin strategjik të mekanizmit, monitorimin e funksionimit të tij, identifikimin e problematikave, përmirësimin e politikave vendore, zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe parandaluese, si dhe garantimin e fondeve për trajtimin e rasteve emergjente, si dhe shërben gjithashtu si hallkë lidhëse ndërmjet nivelit vendor dhe institucioneve të nivelit qendror.

Në vijim, *znj. Sheshi* prezantoi rolin e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar, duke theksuar se ai është struktura operacionale përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje deri në mbylljen e tyre. ENT-ja funksionon mbi bazën e procedurave të detajuara të ndërhyrjes dhe drejtohet nga Koordinatorin Vendor, si dhe garanton përfshirjen aktive të viktimës në hartimin dhe zbatimin e planit të ndërhyrjes, organizon shërbimin e gatishmërisë 24 orë për

rastet emergjente dhe vepron mbi bazën e afateve të përcaktuara, duke siguruar reagim të shpejtë dhe të koordinuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse.

Duke u ndalur te figura e Koordinatorit Vendor, *znj. Sheshi* e cilësoi atë si elementin kyç të funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, si dhe sqaroi se numri i koordinatorëve vendorë përcaktohet në bazë të numrit të popullsisë dhe prevalencës së rasteve të evidentuara në secilën njësi të vetëqeverisjes vendore, duke marrë në konsideratë edhe kapacitetet njerëzore të bashkive. *Znj. Sheshi* theksoi se, për shkak të natyrës së shërbimit dhe nevojës për reagim të vazhdueshëm, funksioni i Koordinatorit Vendor nuk mund të ushtrohet si detyrë shtesë nga punonjës të tjerë të bashkisë, pasi rastet e dhunës mund të ndodhin në çdo kohë dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

Në vijim, *znj. Sheshi* paraqiti përgjegjësitë kryesore të Koordinatorit Vendor, të cilat përfshijnë koordinimin dhe menaxhimin e integruar të rasteve sipas qasjes me në qendër viktimën, organizimin e vlerësimit të koordinuar të riskut për çdo rast, ndërhyrjen e menjëhershme në rastet me risk të lartë, garantimin e aksesit të viktimës në shërbimet mbështetëse, bashkërendimin ndërinstitutional, asistimin për marrjen dhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes, monitorimin e tyre në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe organet e drejtësisë, si dhe kryerjen e detyrimeve raportuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere.

Znj. Sheshi theksoi se projektvendimi vendos rregulla të unifikuara për trajtimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të zbatueshme për çdo viktimë, përfshirë edhe shtetasit e huaj. Gjithashtu, projektakti garanton të drejtën e viktimave për të raportuar rastet e dhunës përmes kanaleve të ndryshme, përfshirë mjetet elektronike, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e informacionit.

Znj. Sheshi sqaroi gjithashtu se projektvendimi përcakton në mënyrë të detajuar procedurat për aktivizimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe menaxhimin fillestar të rasteve, duke synuar një reagim të shpejtë, të koordinuar dhe efektiv nga të gjitha institucionet përgjegjëse.

Në përfundim të prezantimit, *znj. Sheshi* trajtoi edhe aspektin financiar të projektvendimit. Numri i Koordinatorëve Vendorë do të miratohet me vendim të këshillit bashkiak, mbi bazën e numrit të popullsisë dhe rasteve të evidentuara të dhunës. Projektvendimi parashikon shtimin e dhjetë koordinatorëve vendorë në raport me numrin aktual, si dhe parashikime për kompensimin e punës së kryer jashtë orarit zyrtar, gjatë fundjavave dhe ditëve të festave zyrtare.

Komente nuk ka.

7. Projektvendimi “Për organizimin, funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe procedura e shqyrtimit të ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje”
8. Projektvendimi “Për rregullat dhe procedurat e monitorimit të situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe organizimin dhe zbatimin e monitorimit dhe inspektimit të shërbimit”
9. Projektvendimi “Për kriteret dhe procedurat e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje”

- 10. Projektvendimi “Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje dhe kriteret, procedurat dhe instrumentet për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje”**
- 11. Projektvendimi “Për rregullat dhe procedurat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ në familje, ofrimin dhe përfundimin e shërbimit, funksionimin e komisionit shumëdisiplinor dhe për vlerësimin e procedurës dhe vendimmarrjen për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje”**

Znj. Nertila Topulli, Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit të Politikave të Përkujdesit Social dhe Shërbi-meve Sociale të Integruara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prezantoi paketën ligjore “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”.

Znj. Topulli, sqaroi se këto akte nënligjore janë të domosdoshme për operacionalizimin e ligjit të ri, duke vendosur kuadrin e detajuar procedural dhe institucional për funksionimin e sistemit të kujdesit alternativ në nivel vendor dhe qendror. Të gjitha projektvendimet mbështeten mbi nenin 100 të Kushtetutës, janë të harmonizuara me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, Konventën Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës dhe acquis të BE-së, dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë. Znj. Topulli filloi prezantimin e aktit të parë si vijon;

- 1. Projektvendimi “Për organizimin, funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe procedura e shqyrtimit të ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje”**

Znj. Topulli sqaroi se ky akt ka për qëllim krijimin e një kuadri të plotë rregullator për funksionimin e komisionit për 61 bashki, duke garantuar trajtim të barabartë, të standardizuar dhe të unifikuar të ankesave. Komisioni ngrihet pranë çdo bashkie si organ kolegjal i qëndrueshëm administrativ, me pesë anëtarë me profil multidisiplinar: punonjës social, psikolog, jurist, të emëruar nga kryetari i bashkisë mbi bazën e përgjegjësisë kolegjiale. Ai funksionon në mënyrë të pavarur nga strukturat e tjera të bashkisë dhe mbështetet nga një sekretariat teknik. Parashikohen rregulla të qarta për konfliktin e interesit dhe zëvendësimin e anëtarëve. Komisioni shqyrton vendimet që lidhen me përzgjedhjen ose refuzimin e familjes kujdestare, vendosjen, transferimin ose ndërprerjen e vendosjes së fëmijës, si dhe çdo vendim administrativ që prek të drejtat dhe mirëqenien e tij. E drejta e ankimit u njihet fëmijës, përfaqësuesve ligjorë, familjeve biologjike dhe kujdestare, si dhe organizatave me interes legjitim. Afati i paraqitjes së ankesave është 30 ditë sipas Kodit të Procedurës Administrative. Ankesa mund të paraqitet me shkrim, elektronikisht ose drejtpërdrejt pranë Komisionit. Procedura përfshin mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit, mbledhjen e komisionit, seanca dëgjimore me të gjitha palët e interesuara, si dhe dëgjimin e fëmijës në mënyrë të përshtatshme me moshën. Vendimi është i arsyetuar juridikisht dhe faktikisht, me njoftim brenda 3 ditëve dhe të drejtë ankimi të mëtejshëm në gjykatë. Sekretariati garanton konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- 2. Projektvendimi “Për rregullat dhe procedurat e monitorimit të situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe organizimin dhe zbatimin e monitorimit dhe inspektimit të shërbimit”**

Znj.Topulli sqaroi se projektvendimi i dytë rregullon monitorimin e situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ dhe organizimin e inspektimit të shërbimit. Akti synon krijimin e një sistemi të unifikuar monitorimi dhe inspektimi, të bazuar në standarde dhe vlerësim risku. Monitorimi realizohet në tre nivele: nivel vendor, bashkitë, me monitorim të drejtpërdrejtë; nivel rajonal dhe qendror, Shërbimi Social Rajonal (12 rajone) dhe Shërbimi Social Shtetëror; dhe nivel politik, mbikëqyrje e ministrisë përgjegjëse. Strukturat vendore kryejnë monitorimin e drejtpërdrejtë të dosjes dhe dokumentacionit, ndërsa shërbimi social monitoron zbatimin e standardeve mbi bazë indiciesh. Për familjet kujdestare profesionale, të reja në sistem, monitorimi kryhet dy herë në muaj gjatë muajve të parë dhe një herë në muaj më pas, me monitorim të menjëhershëm në raste risku apo në bazë indiciesh. Projektvendimi parashikon katër nivele risku: i ulët, i mesëm, i lartë dhe emergjent, që përcaktojnë intensitetin e ndërhyrjes, si dhe masa korrigjuese të diferencuara me afate të caktuara. Inspektimet mund të jenë të planifikuara, të paplanifikuara, tematike ose emergjente.

3. Projektvendimi “Për kriteret dhe procedurat e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje”

Znj.Topulli sqaroi se projektvendimi i tretë përcakton kriteret, procedurat dhe mënyrën e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në ofrimin dhe mbështetjen e shërbimeve të kujdesit alternativ, duke njohur rolin e rëndësishëm që kanë këto organizata në këtë proces. Fushat kryesore të përfshirjes së OSHC-ve janë: identifikimi i familjeve kujdestare dhe ndërgjegjësimi komunitar; mbështetja dhe trajnimi i tyre deri në certifikim; mbështetja e vazhdueshme e familjeve dhe fëmijëve; si dhe mbështetja e bashkive në proceset e monitorimit dhe vlerësimit. Format e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshijnë: marrëveshje bashkëpunimi, kontraktim për shërbimet sociale dhe përfshirje në mekanizmat ndërinstucionalë. Projektvendimi parashikon një sistem objektiv vlerësimi me 100 pikë, që mbulon kriteret ligjore e administrative, profesionale e teknike, organizative e menaxheriale, financiare e të qëndrueshmërisë, si dhe të integritetit dhe sigurisë. Procedura ndjek hapat: thirrje për shprehje interesi, përzgjedhje konkurruese dhe transparente, vlerësim nga komisioni dhe lidhja e marrëveshjeve ose kontratave. Parashikohet verifikim i detyrueshëm i integritetit të stafit.

4. Projektvendimi “Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje dhe kriteret, procedurat dhe instrumentet për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje”

Znj.Topulli sqaroi se projektvendimi i katërt përcakton ciklin e plotë të menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë, duke standardizuar çdo hap të procesit dhe duke garantuar gjurmueshmëri dhe transparencë. Procedura e menaxhimit përfshin: a) identifikimin e fëmijës në nevojë, b) raportimin e detyrueshëm brenda 24 orëve, c) vlerësimin fillestar brenda 24-48 orëve për nivelin e rrezikut, ç) vlerësimin e plotë brenda 20 ditëve (5 ditë për rastet urgjente), d) hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes (PIM) dhe Planit Individual të Kujdesit (PIK), dh) monitorimin periodik si dhe transferimin dhe mbylljen e rastit sipas rrethanave (rikthim në familjen biologjike), e) birësim ose mbushje e moshës 18 vjeç. Parashikohen formularë dhe instrumente standarde: PIK, formulari i vlerësimit periodik, matrica e riskut dhe raportet statistikore. Menaxheri i rastit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, përgjigjet për administrimin e dosjes dhe koordinimin e shërbimeve. Funkcionon një Grup Teknik Ndërsektorial (GTN) si mekanizëm koordinues dhe Komisioni Multidisiplinar si

organ vendimmarrës. Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ garanton gjurmueshmëri. Projektvendimi përfshin gjithashtu procedura të qarta për riintegrimin e fëmijës në familjen biologjike, përfshirë vlerësimin e kapaciteteve prindërore, kontaktet graduale dhe monitorimin pas kthimit.

5. Projektvendimi “Për rregullat dhe procedurat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ në familje, ofrimin dhe përfundimin e shërbimit, funksionimin e komisionit shumëdisiplinor dhe për vlerësimin e procedurës dhe vendimmarrjen për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje”

Znj.Topulli sqaroi se projektvendimi i fundit është instrumenti themelor i paketës, duke rregulluar tërësinë e procedurës nga identifikimi i nevojave të fëmijës deri në vendosjen e tij në familjen kujdestare i cili përcakton dy kategori kryesore;

- Kujdesin profesional, i ofruar nga familje të trajnuara dhe të certifikuara për nevoja komplekse, përfshirë kujdesin emergjent, afatshkurtër, afatgjatë ose të specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuara ose trauma;
- Kujdesin për vajza nëna, dhe kujdesin vullnetar, i cili ofrohet nga të afërmit ose miqtë e ngushtë të fëmijës. Përcaktimi i llojit të kujdesit bazohet në vlerësim të plotë të nevojave të fëmijës, duke marrë parasysh moshën, gjendjen shëndetësore e psikologjike, historinë e traumës, marrëdhëniet me familjen biologjike dhe mendimin e vetë fëmijës.

Pranë çdo bashkie ngrihet një Komision Shumëdisiplinar me nëntë anëtarë me ekspertizë nga shërbimet sociale, mbrojtja e fëmijës, arsimi, shëndetësia, policia, drejtësia dhe psikologjia. Ky organ shqyrton aplikimet e familjeve kujdestare, vendos mbi miratimin ose refuzimin e tyre, përcakton llojin më të përshtatshëm të kujdesit dhe monitoron ecurinë e vendosjes. Procedura ndjek hapat: vlerësim i rastit, vendim i komisionit, miratim gjyqësor dhe vendosje në familjen kujdestare. Çdo vendim mbahet i dokumentuar dhe i regjistruar elektronikisht.

Paketa e projektvendimeve si tërësi pritet të sjellë: a) profesionalizim të familjeve kujdestare, b) reduktim progresiv të institucionalizimit të fëmijëve, c) forcim të mbrojtjes së fëmijëve, d) rritje të transparencës dhe llogaridhënies institucionale dhe standardizim të praktikave në nivel kombëtar. Të gjitha projektvendimet janë në përputhje me detyrimet europiane sipas Kapitujve 19 dhe 23 të *acquis-it*.

Komente:

Znj.Vjero shprehu mbështetjen e saj për të gjithë paketën, duke vlerësuar rëndësinë e lartë të projektvendimeve. Ajo paraqiti një sërë sugjerimesh konkrete. Lidhur me projektvendimin për organizimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, propozoi që në nenin 2 të specifikohet shprehimisht se ky komision është i ndryshëm nga Komisioni Multidisiplinar i kujdestarisë; që në nenin 3, pika 1, të përfshihen në përbërje edhe përfaqësues nga burimet njerëzore dhe që në nenin 7, pika 5, të shtohen edhe përfaqësuesit e Policisë së Shtetit. Lidhur me projektvendimin për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, propozoi që në pikën 2 të nenit 3 të përcaktohet se komisioni ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe të specifikohet përbërja e tij dhe që në nenin 3, shkronja a), të shtohet detyrimi që organizatat të kenë marrëveshje bashkëpunimi me bashkinë ku zhvillojnë

aktivitetin, si dhe të parashikohet detyrimi i raportimit të organizatave pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. *Znj.Vjero* njoftoi se këto komente janë dërguar edhe me shkrim.

Z. Brahimi vlerësoi lart punën e bërë dhe bashkëpunimin me ministrinë, duke i cilësuar projektvendimet si tejet të dobishme për zgjidhjen e problemeve sociale në nivel vendor. Megjithatë, argumentoi lidhur me anën financiare ku edhe pse relacionet paraqesin këto vendime si pa kosto, rolet dhe përgjegjësitë e reja që u ngarkohen bashkive mbartin kosto të fshehura. Sipas tij, mosevidentimi i tyre rrezikon të lërë vendime të mira të pazbatuara, pasi buxhetet e bashkive të vogla nuk kanë fleksibilitet për shpenzime të paparashikuara.

Znj.Topulli sqaroi se projektvendimet nuk sjellin procedura të reja, por bazohen në sistemin ekzistues. Ndryshimi kryesor është zëvendësimi i rolit të familjes së gjakut me familjen e kujdesit alternativ profesional, për të cilën efekti financiar është parashikuar në një projektakt specifik ende në proces pune. Detyrat shtesë për njësitet e vlerësimit dhe punonjësit e mbrojtjes janë risjellje e detyrave funksionale ekzistuese, në përputhje me Ligjin nr. 121 dhe Ligjin nr. 92. Ajo theksoi se i gjithë procesi, përfshirë buxhetimin, është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Financave.

Znj.Topulli sqaroi se risia kryesore e reformës është futja për herë të parë e konceptit të familjes kujdestare profesionale, duke marrë si pikënisje pilotimin e suksesshëm të Bashkisë së Vlorës. Bashkitë marrin rol kyç në identifikimin, trajnimin dhe rekrutimin e këtyre familjeve, ndërsa financimi do të funksionojë në mënyrë të ngjashme me Fondin Social ku bashkitë alokojnë fondet e tyre dhe aplikojnë për grante shtesë. Qëndrueshmëria e modelit do të sigurohet përmes një VKM-je të re që do të parashikojë kostot financiare dhe pagesat mujore për familjet kujdestare profesionale.

Znj.Toshkallari, Zv/Kryetare e bashkisë Vlorë ngriti një çështje terminologjike duke qenë se Bashkia e Vlorës e ka kujdesin alternativ të integruar tek IPSH-ja dhe ShMFF-ja, propozoi që neni 6 të citojë këto struktura konkrete dhe jo termin e përgjithshëm “struktura përgjegjëse e shërbimit social”. Në diskutimin që pasoi u sqarua se IPSH-ja është transformuar tashmë me urdhër të Kryeministrit dhe se me vendim të Këshillit Bashkiak bashkia ka përshtatur ShMFF-në si shërbim mbështetës për fëmijën dhe familjen, duke integruar edhe shërbimet e mëparshme të IPSH-së.

Z. Jaupllari, Zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural falenderoi Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për paketën e prezantuar dhe vuri në dukje se ligjet e reja mund të sjellin shpenzime të papritura në të ardhmen dhe theksoi nevojën që qeveria të planifikojë paraprakisht fondet e nevojshme. Gjithashtu, shprehu shqetësimin se fondet e ndihmës ekonomike në nivel vendor shpesh nuk shkojnë në drejtimin e duhur.

12. Prezantim i “Udhërrëfyesit mbi planin vjetor të aktiviteteve të komisionit të këshillimit ad hoc” “Mekanizmi për verifikimin e përfshirjes së rekomandimeve të këshillit konsultativ” “Guida praktike mbi metodologjinë e hartimit të rekomandimeve/propozimeve për iniciativa ligjore”

Znj.Aulona Hasbiu, eksperte pranë Projektit EU4GOOD GOVERNANCE, prezantoi dokumentat mbi;

- “Udhërrëfyesin e planit vjetor të aktiviteteve të komisionit të këshillimit ad hoc”;
- “Mekanizëm për verifikimin e përfshirjes së rekomandimeve të këshillit konsultativ”;
- “Guidë praktike mbi metodologjinë e hartimit të rekomandimeve/propozimeve për iniciativa ligjore”.

Znj. Hazbiu prezantoi punën e kryer në kuadër të projektit, në bashkëpunim me AMVV dhe Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor për strukturimin e procesit të përfshirjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NjVV) në hartimin dhe propozimin e akteve që ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e tyre. Ajo sqaroi se sfondi i propozimit rrjedh nga detyrimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, dhe se fokusi kryesor është rritja e efektivitetit të dialogut ndërmjet dy niveleve të qeverisjes. Ky dialog mbështetet në dy shtylla: kuadrin ligjor të mirëpërcaktuar dhe strukturën institucionale të përshtatshme.

Znj. Hazbiu shpjegoi se nga ana e projektit dhe e Agjencisë janë ndërmarrë dy hapa konkretë:

- ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Këshillimit Ad Hoc si strukturë që rrit efikasitetin e Këshillit;
- hartimi i një seti dokumentesh që strukturojnë dhe standardizojnë procesin e dialogut dhe përfshirjes.

Znj. Hazbiu theksoi se, sipas analizës së kryer, rekomandimet e paraqitura nga Këshilli shpeshherë kanë marrë formën e vërejtjeve dhe jo të alternativave konkrete, ndërsa mungon një kalendar institucional i strukturuar paralel me kalendarin legjislativ të qeverisjes qendrore. Me asistencën e projektit EU4GOOD GOVERNANCE janë hartuar katër dokumente: (a) Udhërrëfyesi mbi planin vjetor të aktiviteteve të Komisionit të Këshillimit Ad Hoc; (b) Guidë praktike mbi metodologjinë e hartimit të rekomandimeve; (c) Formulari i ndjekjes së rekomandimeve të paraqitura nga Këshilli Konsultativ; dhe (d) Mekanizmi i përfshirjes së rekomandimeve të Këshillit Konsultativ. *Znj. Hasbiu* shpjegoi se këto dokumente ndërlidhen në krijimin e një kalendari institucional, mundësojnë NjVV-ve të paraqesin propozime të maturuara juridikisht dhe krijojnë ciklin e plotë konsultim–verifikim–raportim, ndërkohë që të gjitha materialet gjenden edhe në faqen e internetit të AMVV-së.

Komente;

Znj. Vjetro shtroi pyetjen nëse rekomandimet e Këshillit Konsultativ kanë ndonjë mekanizëm që i bën të detyrueshme, si dhe nëse ekziston mundësia e raportimit mbi shkallën e përfshirjes së tyre nga institucionet propozuese, si dhe propozoi që Këshilli të pajisej me planin vjetor të akteve të qeverisë, jo vetëm ato të procesit të integritetit evropian, por edhe aktet e tjera rutinë, me qëllim që të njihje paraprakisht axhendën legjislativë dhe të orientonte punën e vet sipas tremujorit.

Znj. Hazbiu sqaroi se, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve evropiane, roli i Këshillit Konsultativ është rekomandues dhe jo detyrues. Qeveria qendrore mbetet organi që miraton VKM-të, dhe çdo ministri apo organ propozues ka diskrecionin të pranojë ose jo rekomandimet. Ajo shtoi

se edhe pse detyrimi ligjor mungon, projekti po punon për të kuptuar ndikimin real të rekomandimeve nëpërmjet analizës së relacionit të konsoliduar, ku pasqyrohet çfarë është rekomanduar, çfarë është pranuar dhe çfarë jo, dhe për t'ia paraqitur Këshillit me argumentet përkatëse. *Znj. Hazbiu* theksoi se sfida kryesore qëndron në dy aspekte:

- Të përfshihen sa më herët në procesin e hartimit të ligjit, kur dialogu ka impakt real *dhe*;
- Të sigurohet që dialogu të jetë cilësor e jo formal, duke pasur parasysh se bashkitë janë ato që e zbatojnë legjislacionin në terren.

Z. Moçka shtoi se edhe pse rekomandimet nuk janë detyruese, ato kanë efekte reale mbi organet vendimmarrëse. Ai përmendi raste konkrete ku projektvendimet janë tërhequr ose ndryshuar si rezultat i propozimeve të Këshillit, si dhe raste ku diskutimet e zhvilluara në këtë forum kanë çuar në amendime ligjore ose shtojca në legjislacionin ekzistues dhe vlerësoi rëndësinë e forumit, por nënvizoi nevojën për t'i përsosur mekanizmat, veçanërisht për ato projektakte që ndikojnë drejtpërdrejt në pushtetin vendor dhe komunitetin.

Z. Dalipi, duke vlerësuar kontributin e të gjithë pjesëmarrësve, rikujtoi se Këshilli Konsultativ ka filluar aktivitetin që në vitin 2017 falë kontributit të bashkive dhe Shoqatës së Qeverisjes Vendore, dhe se gjatë gjithë kësaj periudhe mendimi i qeverisjes vendore është marrë në konsideratë në shumicën e rasteve. Ai theksoi se platforma ka ndikuar ndjeshëm në transparencën e vendimmarrjes dhe në cilësinë e dialogut ndërmjet dy niveleve të qeverisjes, duke e afruar vendimmarrjen me qytetarët dhe komunitetin. *Z. Dalipi* shprehu nevojën për të avancuar mekanizmat që forcojnë rolin e Këshillit Konsultativ dhe garantojnë që vendimet e qeverisjes vendore të reflektohen me besnikëri në vendimmarrjen e qeverisë qendrore., si dhe në mbyllje falënderoi përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe drejtuesit e institucioneve qendrore për angazhimin e tyre në këtë proces konsultimi.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë
2	Orjana Osmani	Zv /ministër	Ministria e Arsimit
3	Fran Brahimi	Drejtor	Ministria e Financave
4	Arian Jaupllari	Zv/ministër	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Shënim: Materialet e diskutuara në mbledhjen e datës 24 qershor 2026 mund t'i gjeni në linkun e mëposhtëm;

<https://qeverisjavendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2026/qershor-2026/>

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ *E-mail:* keshilli.konsultativ@amvv.gov.al *Adresa:* *Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.*